



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

## GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2020:159878

Datë: 30.08.2023

Numri i dokumentit: 04629503

**Ac.nr.6682/2022**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, gjyqtari individual Lumni Sallauka, në çështjen juridike përmbartimore të kreditores Miradije Bogaj nga Prishtina, e përfaqësuar me autorizim nga Shoqëria e Avokatëve “Vokshi&Lata”, në Prishtinë, kundër debitorit: “Rossman Kosovo” Sh.P.K, në Prishtinë, Llapnasellë, Zona R, Shiroko Polje, e përfaqësuar me autorizim nga Qendrim Arifaj, avokat në Prishtinë, lidhur me çështjen përmbartimore kërkesa në të holla, duke vendosur lidhur më ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm PPP.nr. 2928/2020, të datës 24.06.2022, me datën **29.08.2023**, mori këtë:

### A K T V E N D I M

**REFUZOHET** si e pathemeltë ankesa e debitorit “Rossman Kosovo” Sh.P.K, në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm PPP.nr. 2928/2020, i datës 24.06.2022, **VËRTETOHET**.

### A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin e atakuar PPP.nr.2928/2020, të datës 24.06.2022, ka vendosur: **“REFUZOHET I PABAZUAR** prapësimi i debitorit “Rossman Kosovo” sh.p.k., në Prishtinë, i ushtruar kundër Urdhrit për lejimin e përmbartimit P.nr.1436/20 i datës 21.10.2020, i lejuar nga përmbartuesi privat Flamur S.Bogaj, në Prishtinë”.

Kundër këtij aktvendimi, brenda afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori për shkak të shkeljes së ligjit të procedurës dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovon ankesën e debitorit si të bazuar, ta anulon aktvendimin e atakuar ashtu që çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Përgjigje në ankesë nuk ka ushtruar kreditorja.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas shqyrtimit të tyre, konform nenit 17 të LPP, si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK, gjeti se:

- Ankesa e debitorit është **e pathemeltë**.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditorja, përmes përfaqësuesit të saj të autorizuar, ka paraqitur propozim për përmbarrim ndaj debitorit në bazë të dokumentit përmbarrues – Aktit noterial (kontrata për qiranë) të noterit Burim Z. Xhemajli, me numër LRP.nr.1244/2020 – Ref.nr..227/2020 i dt.26.06.2020, me arsyet sikurse në propozimin për përmbarrim.

Përmbarruesi Privat Flamur S. Bogaj, me urdhrin P.nr.1436/20, të datës 21.10.2020, e ka lejuar propozimin për përmbarrim.

Debitori me datën 03.11.2020, ka ushtruar prapësim, ndërsa kreditorja ka paraqitur përgjigje në prapësim me datën 09.11.2020. Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit të prapësimit të debitorit dhe përgjigjes në prapësim të kreditores ka vendosur si në aktvendimin e atakuar PPP.nr. 2928/2020, të datës 24.06.2022.

Duke vendosur në lidhje me ankesën e debitorit, Gjykata e Apelit vlerëson se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të parashikuara me nenin 182 par.2 të LPK-së, për arsye se i njëjti është i kuptueshëm, i qartë dhe përmban arsye të mjaftueshme bindëse faktike dhe juridike mbi faktet vendimtare, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, e të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së. Për shkak të zbatimit të rregullt të dispozitave të procedurës përmbarrimore dhe për shkak të hetimit të rregullt dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata përmbarrimore drejtë e ka aplikuar edhe të drejtën materiale, aplikimin e drejtë të së cilës gjykata e shkallës së dytë e heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar drejtë provat të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës të ofruara nga palët ndërgjyqëse, ka vendosur drejtë në dispozitiv të vendimit duke dhënë arsye përkatëse në pjesën arsyetuese të aktvendimit të atakuar dhe drejtë ka aplikuar edhe Ligjin për Procedurën Përmbarrimore. Rrjedhimisht, dokumenti përmbarrues - Akti noterial (kontrata për qiranë) i noterit Burim Z.Xhemajli, me numër LRP.nr.1244/2020 – Ref.nr.227/2020 i dt.26.06.2020, në bazë të së cilit përmbarruesi privat ka zbatuar përmbarrimin, përbën bazë juridike për caktimin e përmbarrimit, ngase i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 21, 22 par.1.3, 26 dhe neni 27 par.1 të LPP-së, për të qenë i përmbarrueshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përmbarrim. Dispozita e nenit 21 të LPP-së parasheh bazat juridike për caktimin e përmbarrimit, ku shprehimisht përcaktohet se "Organi përmbarrues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarrimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarrues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër." Ndërsa dispozita e nenit 22 parasheh se cilat janë dokumente përmbarruese ku në par. 1, nënpar.1.2 shprehimisht përcaktohet se "1. Dokumente përmbarruese janë: ... 1.3. dokumenti noterial i përmbarrueshëm në pajtim me ligjin për noterinë"

Kjo Gjykatë e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë, drejtë ka arsyetuar mënyrën e vendosjes së saj në bazë të dokumentit përmbarues- dokumenti notarial, përkatësisht Akti notarial (kontrata për qiranë), me numër LRP.nr.1244/2020 – Ref.nr..227/2020 i dt.26.06.2020, e cila është pjesë e propozimit për përmbarim, bazuar në nenin 26 par.1 të LPP-së, I cili shprehimisht parasheh se “Dokumenti i noterizuar është i përmbarueshëm nëse është bërë i përmbarueshëm sipas rregullave të veçanta që rregullojnë përmbarueshmërin e atij dokumenti.”

Sa i përket pretendimit ankimor të debitorit se në këtë çështje përmbarimore ka të bëjë me mashtrim sa i përket metrave katrorë lokalit të lëshuar me qira dhe se kreditorja nuk e ka lëshuar objektin në datën kur është potencuar në kontratë, andaj konsideron se kontrata në fjalë është zgjidhur bazuar në dispozitat e LMD-së që rregullojnë këtë çështje, Gjykata e Apelit vlerëson se janë pretendime të cilat do të mund të paraqiteshin në një procedurë kontestimore dhe si të tilla edhe të shqyrtohen nga gjykata, mirëpo nuk merren si të bazuara në procedurën përmbarimore gjatë shqyrtimit të kësaj çështje në rastin konkret.

Duke marrë parasysh këto pretendime ankimore të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar gjykata e shkallës së dytë konsideron se të njëjtat janë të pabazuara ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbarimore. Andaj me të drejtë gjykata e shkallës së parë e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit.

Gjykata e Apelit shqyrtoi edhe pretendimet e tjera ankimore të debitorit dhe vlerëson se janë të paqëndrueshme dhe të pabazuara në ligj, për arsye se nuk ka ofruar prova në mbështetje të pretendimeve të tij siç është paraparë me nenin 69 par. 4 të LPP-së, se nuk janë përmbushur asnjë nga kushtet ligjore për anulimin e Urdhrit të Përmbaruesit Privat apo shtyrjen e zbatimit të përmbarimit, të përcaktuara me dispozitat e nenit 61 par.1 pika 1 dhe nenit 71 par.1, pika 1 deri në 12 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (Ligji nr. 04/L-139), të Republikës së Kosovës, mirëpo kreditori i përmbarimit në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, mundet që për kërkesën e tij të kërkojë mbrojtje gjyqësore në kontest të rregullt civil pranë gjykatës kompetente.

Nga sa u tha me lartë, Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.6682/2022, datë 29.08.2023**

**Gjyqtari,**  
**Lumni Sallauka**